

STRATEGJIA AFATMESME E ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR PERIUDHËN 2025-2027

Strategjia afatmesme e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë
për periudhën 2025-2027, u miratua nga
Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin
nr.58, datë 20.11.2024.

Këtë publikim mund ta gjeni në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

public@bankofalbania.org

P Ë R M B A J T J A

1. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT	5
2. OBJEKTIVAT AFATMESËM	7
2.1. Rritja e eficiencës, efektivitetit të politikës monetare dhe e cilësisë së vendimmarrjes	7
2.2. Parandalimi i rreziqeve sistemike dhe rritja e rezistencës së sistemit financiar	9
2.2.1. Forcimi i rolit të politikës makroprudenciale	9
2.2.2. Siguria dhe shëndeti i sistemit bankar	10
2.2.3. Ndërhyrja e jashtëzakonshme në bankat me paftësi paguese	12
2.3. Nxitja e funksionimit normal të sistemit të pagesave	13
2.4. Ruajtja e besimit publik të kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare	14
2.5. Administrimi i rezervës valutore	15
2.6. Hartimi dhe shpërndarja e statistikave	16
2.7. Kërkimi shkencor	17
2.8. Komunikimi me publikun	18
2.9. Edukimi financiar	18
2.10. Mjaftueshmëria e burimeve njerëzore, fizike dhe financiare për të përmbushur objektivat ligjorë	19
2.11. Siguria kibernetike	21

Strategjia Afatmesme e Zhvillimit identifikon sfidat me të cilat do të përballet Banka e Shqipërisë gjatë periudhës trevjeçare në vijim. Strategjia priorizon objektivat kryesorë dhe planifikon veprimtaritë e nevojshme për arritjen e tyre. Këto objektiva, më pas, zbërthehen dhe detajohen në planet vjetore të punës së departamenteve.

Strategjia shërben si kornizë orientuese për procesin e buxhetimit në Bankën e Shqipërisë. Procesi i parashikimit të shpenzimeve dhe të ardhurave organizohet në funksion të përmbushjes së detyrave të ngarkuara nga ligji organik dhe të objektivave strategjike.

Miratimi i Strategjisë nga Këshilli Mbikëqyrës, përbën një aspekt të rëndësishëm të rolit të organit më të lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Ky është një element thelbësor i mirëqeverisjes së institucionit, sa i përket ndarjes së përgjegjësisë, ndërmjet organeve drejtuese, për vendosjen e prioriteteve, përcaktimin e mjeteve për përmbushjen e tyre dhe monitorimin e performancës së realizuar.

1. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT

MISIONI

Si banka qendrore e shtetit, Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive: (i) të hartimit dhe zbatimit të pavarur të politikës monetare, objektivi kryesor i së cilës – stabiliteti i çmimeve – është kontributi më i mirë që mund të japë politika monetare për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë ekonomike të vendit; (ii) të nxjerrjes dhe qarkullimit të monedhës shqiptare, duke siguruar ruajtjen e besimit publik të paraqja, përmes garantimit të cilësisë së kartëmonedhave dhe monedhave, si dhe plotësimin të sigurt dhe eficient të nevojave të ekonomisë për para; (iii) të mbajtjes dhe administrimit të rezervave valutore të Republikës së Shqipërisë, si një garanci për përbalimin e goditjeve të rënda në sektorin real të ekonomisë në mbështetje të qëndrueshmërisë financiare të vendit.

Si emetuese e monedhës kombëtare, Banka e Shqipërisë nxit funksionimin normal të sistemit të pagesave, duke synuar: qarkullimin e sigurt, të shpejtë dhe me kosto të ulët të parasë në ekonomi; parandalimin e rrezikut sistemik; dhe ruajtjen e stabilitetit të institucioneve dhe tregjeve financiare.

Banka e Shqipërisë promovon stabilitetin e sistemit financiar – besimin publik tek institucionet, tregjet dhe infrastruktura financiare – përmes: rregullimit, licencimit dhe mbikëqyrjes së bankave dhe institucioneve të tjera financiare; identifikimit dhe analizimit të rreziqeve dhe kërcënimeve ndaj stabilitetit financiar; dhe sigurimit të ndërhyrjes së organizuar në bankat me paftësi paguese, duke minimizuar ndikimin në ekonominë reale dhe financat publike të vendit.

VIZIONI

Banka e Shqipërisë synon adoptimin e standardeve të larta të profesionalizmit dhe mirëqeverisjes, për të garantuar përmbushjen e misionit dhe për të nxitur besimin e publikut, përmes rritjes së:

- a) pavarësisë në përmbushjen e objektivave ligjorë, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga procesi i përafrimit gradual me legjislacionin dhe politikat e Bashkimit Evropian;
- b) llogaridhënies publike mbi përmbushjen e detyrave dhe objektivave ligjorë, duke përfshirë adoptimin e standardeve më të mira të kontabilitetit dhe auditimit, publikimin e raporteve të rregullta financiare dhe sigurimin e integritetit të proceseve të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm;
- c) transparencës mbi veprimtarinë, përmes një komunikimi të hapur dhe të qartë me publikun, në përputhje me ligjin organik, për të rritur kuptueshmërinë dhe parashikueshmërinë e politikës monetare dhe për të forcuar besueshmërinë publike të institucionit.

VLERAT

Në funksion të forcimit të besimit publik, veprimtaria e Bankës së Shqipërisë udhëhiqet nga:

- a) Integriteti dhe etika në përputhje me normat ligjore, morale dhe standardet më të larta të sjelljes; shmangia e çdo ndikimi të papërshtatshëm, nga palë të treta, në përmbushjen e detyrave ligjore;
- b) Kompetenca dhe profesionalizmi;
- c) Efektiviteti dhe efikasiteti në arritjen e rezultateve të synuara, duke përdorur burime minimale; dhe
- d) Puna në grup, inovacioni, iniciativa dhe kreativiteti në përthithjen e ideve të reja.

2. OBJEKTIVAT AFATMESEM

Në përputhje me objektivin e saj kryesor dhe objektivat e tjerë të përcaktuar në ligjin organik, prioritetet në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë do të jenë:

OBJEKTIVAT AFATMESEM	MASAT
<p>2.1. RITJA E EFICIENCËS, EFEKTIVITETIT TË POLITIKËS MONETARE DHE E CILËSISË SË VENDIMMARRJES</p> <p>a) Përmirësimi i kuadrit dhe instrumenteve të politikës monetare</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Përditësimi dhe pasurimi i modeleve makroekonomike, për të rritur cilësinë, saktësinë dhe relevancën e parashikimeve dhe analizave ekonomike e financiare. – Zhvillimi i një agjende kërkimore, e cila ndihmon në adoptimin e metodave bashkëkohore të kërkimit shkencor dhe mbështet hartimin dhe zbatimin e një politike monetare të përshtatshme për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. – Vlerësimi i efektivitetit të instrumenteve të politikës monetare në funksion të optimizimit të përdorimit të tyre dhe zgjerimit të gamës së instrumenteve për adresimin e sfidave të reja, duke ndihmuar në përmbushjen e rolit të politikës monetare.
<p>b) Rritja e bashkërendimit me politikat fiskale</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Forcimi i dialogut dhe shkëmbimit të informacionit me autoritetet fiskale dhe i ndërveprimit në hartimin e strategjive të zhvillimit ekonomik të vendit. – Përmirësimi i analizës dhe parashikimit të ndikimit të politikave monetare dhe fiskale në ekonominë dhe në financat publike të vendit.

OBJEKTIVAT AFATMESËM	MASAT
c) Nxitja e zhvillimit të tregjeve financiare	<ul style="list-style-type: none"> – Rritja e bashkëpunimit me sistemin bankar dhe autoritetet rregulluese, përmes shkëmbimit të informacionit dhe opinioneve, si dhe hartimit të analizave në mbështetje të nismave për zhvillimin e tregut të parasë. – Kalibrimi i vazhdueshëm i strategjisë operacionale të administrimit të likuiditetit të tregut ndërbankar. – Zgjerimi i produkteve financiare për bankat me marrëveshjet SWAP dhe ekzekutimin e ankandeve të shitblerjes së valutës edhe në tregun FORWARD, krahas atij SPOT.
d) Rritja e kontributit në mbështetje të procesit të integrimin evropian	<ul style="list-style-type: none"> – Përbushja e kërkesave të Bashkimit Evropian për përafrimin e legjislacionit të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar. – Forcimi i dialogut me partnerët evropianë në kuadër të raportimeve periodike, në përbushje të detyrimeve dhe angazhimeve që rrjedhin nga procesi i integrimin evropian. – Bashkëpunimi i ngushtë me Qeverinë shqiptare për hartimin e dokumenteve strategjike dhe mbështetjen e reformave strukturore të lidhura me zhvillimin e tregjeve financiare.
e) Përmirësimi i komunikimit me publikun	<ul style="list-style-type: none"> – Përdorimi i një game më të gjerë kanalesh dhe strategjish komunikimi për të zgjeruar audiencën. – Përmirësimi i lexueshmërisë, thjeshtësisë dhe qartësisë së raporteve të politikës monetare dhe raporteve të tjera periodike, si dhe pasurimi i informacionit me të dhëna të reja. – Intensifikimi i përpjekjeve edukuese për të nxitur një kuptim më të mirë të rolit dhe kontributit të Bankës së Shqipërisë në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

OBJEKTIVAT AFATMESEM

MASAT

2.2. PARANDALIMI I RREZIQEVE SISTEMIKE DHE RITJA E REZISTENCËS SË SISTEMIT FINANCIAR

2.2.1. Forcimi i rolit të politikës makroprudenciale

a) Adresimi i rreziqeve të sistemit financiar me fokus të veçantë, rrezikun sistemik dhe sektorin bankar

- Përmirësimi i proceseve të zbatimit të politikës makroprudenciale, përmes pasurimit të instrumenteve makroprudenciale që synojnë rreziqet sistemike strukturore. Miratimi i metodologjisë për zbatimin e shtesës së kapitalit për rrezikun sistemik.
- Monitorimi dhe analizimi i: (i) ndërlidhjes së sektorit bankar me segmentet e tjera të sistemit financiar; dhe (ii) ekspozimeve të përbashkëta dhe të zgjeruara në produkte e në tregje të caktuara, për të identifikuar kanalet e përhapjes së rreziqeve dhe për të parandaluar kthimin e tyre në rreziqet sistemike.
- Rritja e kapaciteteve në kuadër të analizës dhe përmirësimi i rezistencës të saj dhe të sektorit bankar ndaj efekteve të padëshiruara të ndryshimit të klimës, duke përfshirë: (i) vlerësimin e informacionit dhe të dhënave bazë që nevojiten për hartimin e një metodologjie të ushtrimit të provës së rezistencës ndaj ndikimit të ndryshimit të klimës për sektorin bankar; (ii) përcaktimin e kërkesave rregullative që përmirësojnë informacionin mbi ekspozimin e sektorit bankar ndaj efekteve të ndryshimit të klimës; dhe (iii) identifikimin e rolit të politikës makroprudenciale në uljen e rrezikut që rrjedh nga ky ekspozim.
- Përmirësimi i publikimeve që trajtojnë çështje të stabilitetit financiar dhe të politikës makroprudenciale.

OBJEKTIVAT AFATMESËM

MASAT

2.2.2. Siguria dhe shëndeti i sistemit bankar

a) Përafrimi i kuadrit mbikëqyrës me legjislacionin e Bashkimit Evropian

- Adoptimi i standardeve – Bazel III – dhe akteve të tyre zbatuese në Bashkimin Evropian, synon forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit bankar për përhithjen e goditjeve, në mënyrë që bankat të vazhdojnë të financojnë aktivitetin dhe rritjen ekonomike.
- Përditësimi i kuadrit për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe kapitalin rregulator, sa i përket rrezikut të kredisë, rrezikut të tregut dhe rrezikut operacional, si dhe rrezikut të normës së interesit në librin e bankës;
- Rishikimi i kërkesave për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit (perspektiva normative dhe ekonomike) në kuadër të procesit të brendshëm të mjaftueshmërisë së likuiditetit për bankat;
- Përditësimi i kuadrit rregulator për mbikëqyrjen e rrezikut operacional, rrezikut të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe atij kibernetik. Adoptimi i standardeve ndërkombëtare për vlerësimin e mjaftueshmërisë së perimetrit të sigurisë ndaj sulmeve kibernetike dhe të vijueshmërisë së veprimtarisë së subjekteve të licencuara; dhe
- Rritja e bashkëpunimit me bankat ndaj sulmeve kibernetike dhe kontributi aktiv në strukturat e industrisë bankare për shkëmbimin e informacionit dhe bashkërendimin e reagimit, në kohë reale, ndaj çdo incidenti.

b) Konsolidimi i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik

- Hartimi i instrumenteve metodologjike dhe operacionale për një kalibrim më të mirë të kërkesave për kapital të diferencuar, në përputhje me profilin e rrezikut të çdo banke. Metodologjitë e reja do të zbatohen paralelisht me ato ekzistuese gjatë një periudhe kalimtare.

OBJEKTIVAT AFATMESEM	MASAT
c) Rritja e bashkëpunimit mbikëqyrës	<ul style="list-style-type: none"> – Shkëmbimi i informacionit dhe ndërmarrja e ekzaminimeve të përbashkëta me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Agjencinë e Sigurimit të Depozitave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave mbi subjekte jobanka dhe veprimtaritë financiare jashtë juridiksionit të Bankës së Shqipërisë. – Vazhdimi i pjesëmarrjes në kolegjet mbikëqyrëse të grupeve të rëndësishme bankare evropiane dhe lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me banka të tjera qendrore.
d) Adresimi i rrezikut të kredisë	<ul style="list-style-type: none"> – Harmonizimi i procesit të adresimit të rrezikut të kredisë (dhënia, monitorimi, klasifikimi dhe administrimi tërësor i kredive) me praktikën e Bashkimit Evropian, për të përballuar pasojat e rrezikshme që vijnë nga një mjedis lokal e global i pafavorshëm.
e) Rishikimi i kuadrit raportues	<ul style="list-style-type: none"> – Rishikimi i procesit të raportimit të pasqyrave financiare të bankave sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) – për qëllime të raportimit prudencial – dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS), duke ruajtur parametrat mbikëqyrës dhe serinë kohore të të dhënave të raportuara.
f) Zhvillimi i politikave për administrimin e rreziqeve klimatike	<ul style="list-style-type: none"> – Ndërmarrja e nismave të përbashkëta, me institucionet e tjera shtetërore, për identifikimin dhe administrimin e rreziqeve nga ndryshimet klimatike (<i>green finance</i>), për t'i ndihmuar bankat të jenë më rezistente ndaj goditjeve të klimës.
g) Mbrojtja konsumatore	<ul style="list-style-type: none"> – Ndërmarrja e iniciativave për të garantuar interesat e konsumatorëve dhe për të rritur besimin në sistemin financiar, përmes rregullimit efektiv dhe bashkëpunimit të ngushtë me institucione të tjera shtetërore.

OBJEKTIVAT AFATMESËM

MASAT

2.2.3. Ndërhyrja e jashtëzakonshme në bankat me paafësi paguese

<p>a) Fuqizimi i aftësisë së sektorit bankar për planifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Përditësimi i përvitshëm i planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme që përcaktojnë strategjinë e preferuar të ndërhyrjes për secilën bankë. Kjo përfshin mjetet dhe kompetencat për t'u zbatuar në rastin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe përcakton nivelin e MREL-it për secilën bankë. – Hartimi i manualeve teknike të sektorit bankar për përgatitjen e planeve të kontingjencës, në përputhje me kërkesat ligjore.
<p>b) Kërkesat minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Monitorimi i bankave për përmbushjen e niveleve individuale të kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar, deri në përmbushjen përfundimtare të kësaj kërkesë në vitin 2027. – Përditësimi i rregullt i metodologjisë teknike vjetore të përcaktimit të kërkesës minimale, sipas përqaqesjes së Bordit të Përbashkët të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.
<p>c) Adresimi i pengesave ndaj ndërhyrjes së jashtëzakonshme</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Përmbushja, sipas prioriteteve vjetore, e rekomandimeve për forcimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme të bankave, bazuar në rezultatet e vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të Bankës së Shqipërisë. – Monitorimi i vazhdueshëm i masave të marra, nga ana e bankave, për eliminimin e pengesave të identifikuara dhe përditësimin e vlerësimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme.
<p>d) Përditësimi i kuadrit rregullator e metodologjik</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Harmonizimi i praktikave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme me zhvillimet në legjislacionin e BE-së.

OBJEKTIVAT AFATMESEM	MASAT
e) Monitorimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme	<ul style="list-style-type: none"> – Përditësimi i përvitshëm i përlllogaritjes së nivelit të synuar të Fondit dhe i kontributeve vjetore të bankave për plotësimin e tij në afatin dhe nivelin e përcaktuar në ligj. – Monitorimi i administrimit të mjeteve financiare të Fondit, në përputhje me politikën e investimit të miratuar në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave.
f) Forcimi i bashkëpunimit me autoritetet përgjegjëse evropiane	<ul style="list-style-type: none"> – Pjesëmarrje në takime dhe në kolegjet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në funksion të shkëmbimit të informacionit dhe rritjes së bashkëpunimit në lidhje me planifikimin dhe implementimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbi bankat, ose grupet bankare, me operacione ndërkufitare. – Përmirësimi i kuadrit metodologjik dhe automatizimi i proceseve për kryerjen e analizave dhe vlerësimeve në funksion të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në bankë.

2.3. NXITJA E FUNKSIONIMIT NORMAL TË SISTEMIT TË PAGESAVE

a) Operimi dhe mbikëqyrja e sigurt, eficiente dhe efikase e sistemeve AIPS dhe AECH dhe sistemeve të tjera të pagesave	<ul style="list-style-type: none"> – Përditësimi i sistemeve të pagesave që administrohen nga Banka e Shqipërisë, me qëllim funksionimin e tyre në mënyrë të sigurt dhe efikase. – Përditësimi i kuadrit rregullator në fushën e pagesave në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe nevojat e tregut. – Implementimi i një zgjidhjeje për sistemin <i>Instant Payment</i> me Banca d'Italia për të plotësuar parakushtet e nevojshme për t'u ndërlidhur me sistemin TIPS në të ardhmen dhe për të nxitur inovacionin dhe efikasitetin në tregun vendas. – Intensifikimi i përpjekjeve për konsolidimin e funksionit mbikëqyrës për sistemet e shlyerjes së titujve, në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit për Tregjet e Kapitalit.
--	---

OBJEKTIVAT AFATMESËM	MASAT
<p>b) Krijimi i një tregu gjithëpërfshirës për pagesat me vlerë të vogël, me infrastruktura të sigurta dhe efikase dhe një gamë të gjerë instrumentesh e shërbimesh pagesash</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Pjesëmarrja e përshpejtuar në Tregun Unik të Pagesave në EURO (SEPA), përmes përafrimit të kuadrit ligjor e rregullativ dhe drejtimit të institucioneve shqiptare që ofrojnë shërbime pagesash për anëtarësimin individual në këtë treg. – Zbatimi i objektivave të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël, me fokus të veçantë nxitjen e pagesave elektronike. – Mbështetja e nismave të aktorëve të tregut për zhvillimin e inovacioneve në kuadër të promovimit të pagesave elektronike. – Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare dhe bankat qendrore të rajonit, për modernizimin dhe rritjen e ndërveprimeve të pagesave me vlerë të vogël.

2.4. RUAJTJA E BESIMIT PUBLIK TË KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE SHQIPTARE

<p>a) Plotësimi i sigurt dhe eficient i nevojave të ekonomisë për para, në vlerë dhe në strukturë</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Prodhimi i kartëmonedhave dhe monedhave bazuar në kërkesën e ekonomisë për para – në situata normale dhe të jashtëzakonshme – stokun e fondeve logjistike dhe strategjike; dhe në parashikimet e nevojave për vitet në vijim.
<p>b) Përmirësimi i cilësisë së kartëmonedhave në qarkullim</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Nxitja e përdorimit të sistemeve të certifikuar e të autorizuara për pranimin dhe përpunimin e kartëmonedhave nga sistemi bankar. – Përpunimi, paketimi dhe shkatërrimi i kartëmonedhave përmes proceseve të automatizuara dhe bashkëkohore.

OBJEKTIVAT AFATMESËM	MASAT
c) Mbrojtja nga falsifikimi	<ul style="list-style-type: none"> – Përmirësimi i elementeve të sigurisë së kartëmonedhave. – Rritja e bashkëpunimit me organet e tjera shtetërore në luftën kundër falsifikimit. – Forcimi i kapaciteteve të personelit dhe trajnimi i sistemit financiar mbi elementet e sigurisë së kartëmonedhave dhe faktorët që minimizojnë falsifikimin e tyre.
d) Përmirësimi i administrimit fizik të vlerave monetare	<ul style="list-style-type: none"> – Përmirësimi i kushteve dhe mjediseve të depozitimit dhe ruajtjes së vlerave. – Ndërtimi i një objekti të ri për nevojat e emisionit sipas detyrës së projektimit dhe projekt-zbatimit të prokuruar. – Rishikimi, kur është i nevojshëm, i procedurave të administrimit të vlerave, në përputhje me praktikat më të mira të fushës.

2.5. ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

a) Diversifikimi i instrumenteve të investimit	<ul style="list-style-type: none"> – Rritja e kapaciteteve investuese në përputhje me rritjen e nivelit të rezervës valutore. – Diversifikimi i portofolit të rezervës valutore, përmes shtimit të klasave të reja të instrumenteve financiare: (i) <i>mortgage backed securities</i>; (ii) <i>Reverse REPO</i>; (iii) <i>emetimet ESG (environmental, social and governance investing)</i>; (iv) <i>inflation linked bonds</i>; – Implementimi i një sistemi të ri për mbështetjen e funksioneve të administrimit të rezervës valutore, të zbatimit të politikës monetare dhe të shërbimeve të pagesave dhe transfertave, në përputhje me kuadrin e sigurisë kibernetike dhe standardin ISO27001; – Trajnimi i personelit dhe shkëmbimi i përvojës me institucionet homologe dhe bankat partnere. – Përditësimi i bazës rregullative me alternativa të reja në investim për marrëveshjen model <i>Global Master Repurchase Agreement</i> me bankat për instrumentet REPO.
--	---

**OBJEKTIVAT
AFATMESËM**
MASAT
2.6. HARTIMI DHE SHPËRNDARJA E STATISTIKAVE

<p>a) Përafrimi metodologjik me standardet ndërkombëtare dhe legjislationin evropian</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Harmonizimi i statistikave financiare të qeverisë dhe tabelave të procedurës së deficitit të tejkaluar me kërkesat e BE-së mbi cilësinë e të dhënave, fushën e mbulimit dhe metodologjinë. - Përmirësimi i kornizës ligjore dhe aspekteve të cilësisë për raportimin rregullator të të dhënave të mbikëqyrjes bankare, prodhimit dhe përdorimit e statistikave në përputhje me standardet financiare (FINREP) të Autoritetit Bankar Evropian. - Rritja e cilësisë dhe integritetit të statistikave për informimin e politikëbërjes. - Sigurimi i përputhshmërisë me aktet e BE-së për mbledhjen, ruajtjen dhe raportimin e të dhënave, në lidhje me privatësinë dhe konfidencialitetin e informacionit statistikor.
<p>b) Administrimi i integruar i të dhënave dhe ndërveprueshmëria</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i një kornize të mirëpërcaktuar të qeverisjes së të dhënave që përfshin sigurimin e cilësisë, sigurinë dhe protokollet e menaxhimit të të dhënave për të ruajtur integritetin dhe besueshmërinë e informacionit statistikor. - Rritja e koordinimit me organet rregullatore për të përmirësuar proceset e mbledhjes së të dhënave dhe për të zvogëluar barrën në raportim. - Zhvillimi dhe mirëmbajtja e një baze të centralizuar të dhënash për të rritur eficiencën në ruajtje, përpunim dhe shpërndarje të të dhënave statistikore në përputhje me standardet e BE-së. - Adoptimi i praktikave më të mira për administrimin e të dhënave, me fokus: integrimin dhe ndërveprueshmërinë e burimeve të të dhënave për përmirësimin e aftësisë grumbulluese, aksesuese dhe analizuese përtej sistemeve, në përputhje me standardet e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. - Përfshirja e moduleve mbi kornizat e qeverisjes së të dhënave që mbështesin ndarjen e sigurt të të dhënave, duke siguruar cilësi, konsistencë dhe përputhshmëri me kërkesat rregullatore.

OBJEKTIVAT AFATMESËM	MASAT
c) Komunikimi dhe vizualizimi i të dhënave në kohë reale	<ul style="list-style-type: none"> – Zhvillimi i aftësive për raportimin e të dhënave në kohë reale dhe përdorimin e mjeteve të vizualizimit për të mbështetur njohuritë e menjëhershme dhe procese më të shpejta të vendimmarrjes. – Ndërtimi i paneleve të kontrollit (<i>dashboards</i>) që ofrojnë njohuri në kohë reale mbi treguesit kryesorë, duke mbështetur një qasje proaktive ndaj adoptimit të politikave të bankës qendrore. – Informimi proaktiv dhe transparent i publikut dhe palëve të interesuara mbi veprimtaritë statistikore, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave, metodologjitë dhe kalendarin e publikimit. – Zgjerimi i aksesit të të dhënave dhe raportet statistikore, përmes platformave dhe formateve lehtësisht të përdorshme nga përdoruesit. – Përafrimi i praktikave të Bashkimit Evropian mbi afatet e publikimit të raporteve statistikore. – Përfshirja e palëve të interesuara përmes konsultimeve publike, seminareve dhe <i>workshopeve</i>, për të mbledhur <i>feedback</i> dhe për t'u siguruar që nismat statistikore përputhen me nevojat e publikut.

2.7. KËRKIMI SHKENCOR

a) Integrimi i rezultateve të studimeve ekonomike dhe analizave empirike në vendimmarrje	<ul style="list-style-type: none"> – Hulumtimi i fenomeneve të reja – si: zhvillimet globale dhe rajonale në fushën e financës dhe ato të pagesave; digjitalizimi, inovacioni teknologjik dhe kursi i këmbimit, si dhe impakti i tyre mbi familjet, bizneset, ekonominë dhe sistemin financiar. Implikimet e tyre në punën e Bankës së Shqipërisë. – Analizimi i rreziqeve klimatike; ndërtimi i modeleve për vlerësimin e efekteve të tyre në ekonominë shqiptare; dhe përdorimi i tyre në orientimin e vendimmarrjes së politikës monetare dhe të stabilitetit financiar.
--	---

OBJEKTIVAT AFATMESËM	MASAT
b) Rritja e kapacitetit dhe dobishmërisë së projekteve kërkimore	<ul style="list-style-type: none"> – Pasurimi i metodave të kërkimit shkencor me teknika bashkëkohore për qëllime të analizës së fenomeneve makro e mikroekonomike. – Organizimi i konferencave shkencore dhe veprimtarive të përbashkëta, kombëtare e ndërkombëtare, me akademinë, për të nxitur produktivitetin e kërkimit. – Publikimi i punës shkencore në revista ndërkombëtare me reputacion në fushën e ekonomiksit dhe financës.

2.8. KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

a) Sintetizimi i informacionit	<ul style="list-style-type: none"> – Sintetizimi i informacionit teknik në një tekst më të thjeshtuar me qëllim rritjen e kuptueshmërisë së politikave dhe vendimmarrjes të Bankës së Shqipërisë.
b) Rritja e pranisë në mediat sociale	<ul style="list-style-type: none"> – Krijimi i formave të reja të komunikimit për të arritur një publik më të gjerë përmes mediave sociale. – Komunikimi i shtresëzuar, sipas grupeve të interesit, me mesazhe të shkurtra, imazhe lëvizëse e infografikë, si plotësim i analizave dhe fjalimeve të Bankës së Shqipërisë.

2.9. EDUKIMI FINANCIAR

a) Publikimi i historisë së bankës qendrore dhe historisë monetare në Shqipëri	<ul style="list-style-type: none"> – Studimi dhe diskutimi i historikut të Bankës së Shqipërisë dhe i monedhës kombëtare. – Ngritja e ekspozitave të dedikuara për të paraqitur historikun e bankës qendrore dhe monedhës kombëtare. – Plotësimi i arkivit historik të Bankës së Shqipërisë.
--	---

OBJEKTIVAT AFATMESEM	MASAT
b) Zbatimi i Strategjisë së Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare	<ul style="list-style-type: none"> – Organizimi i veprimtarive për rritjen e kulturës dhe përfshirjes financiare në vend, përmes edukimit të publikut në lidhje me: (i) objektivat dhe politikat e Bankës së Shqipërisë; (ii) fenomenet ekonomike dhe financiare; si dhe (iii) kuptimin e instrumenteve të tregut bankar e financiar. – Bashkëpunimi me institucionet e tjera për ngritjen e kësaj strategjie në nivel kombëtar. – Mbështetja e programeve të edukimit në zbatim të Strategjisë së Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare.

2.10. MJAFTUESHMËRIA E BURIMEVE NJERËZORE, FIZIKE DHE FINANCIARE PËR TË PËRMBUSHUR OBJEKTIVAT LIGJORË

a) Zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve njerëzore	<ul style="list-style-type: none"> – Përvetësimi i praktikave më të mira të administrimit të burimeve njerëzore. – Ofrimi i trajnimit cilësor për zbatimin e proceseve/metodave të reja të punës.
b) Përmirësimi i proceseve për miradministrimin e aktiveve dhe burimeve financiare	<ul style="list-style-type: none"> – Reflektimi i kërkesave të reja dhe ndryshimeve në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të aplikueshme për bankën, mbi bazën e të cilave hartohen dhe publikohen pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë. – Trajnimi i personelit mbi zhvillimet e reja në standardet e kontabilitetit dhe interpretimin e tyre nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. – Rishikimi, në vazhdimësi, i kuadrit të përgjithshëm kontabël për t'u përshtatur me evoluimin e standardeve dhe për të ofruar një kornizë të plotë në përputhje me SNRF-të.

OBJEKTIVAT AFATMESËM	MASAT
<p>c) Teknologjia e informacionit</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Modernizimi i mëtejshëm i sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes, si dhe sistemeve të tjera të brendshme, përmes: (i) zgjerimit të funksionaliteteve; (ii) automatizimit të mëtejshëm të proceseve; (iii) përmirësimit të teknologjive në përgjigje të zhvillimeve të industrisë; dhe (iv) rritjes së qëndrueshmërisë së tyre ndaj rreziqeve të teknologjisë dhe kërcënimeve kibernetike. – Përmirësimi dhe optimizimi i infrastrukturës së rrjetit, përmes teknologjive të reja për mbrojtjen e mjedisit dhe eficiencës në energji dhe përdorimin e teknologjisë Cloud për funksione të veçanta. – Forcimi i sigurisë në teknologjinë e informacionit, përmes implementimit të masave rregullative, teknike e procedurale në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe standardeve e praktikave ndërkombëtare. – Përmirësimi i performancës së sistemeve dhe shërbimeve të teknologjisë së informacionit, si dhe proceseve të administrimit e monitorimit të tyre, në funksion të rritjes së efikasitetit, efektivitetit dhe qëndrueshmërisë ndaj rreziqeve të lidhura me teknologjinë e informacionit.
<p>d) Forcimi i rolit të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në përmbushjen e objektivave ligjorë dhe respektimin e politikave të drejtimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Rritja e cilësisë së auditimit të brendshëm dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore. – Zbatimi i programit të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së Auditimit të Brendshëm, në përputhje me standardet e reja ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm. Përmirësimi i vazhdueshëm i administrimit të rrezikut operacional përmes: (i) integritimit me funksionet e njërive dhe përditësimit të proceseve të reja; dhe (ii) implementimit të rezultateve të vlerësimit të rrezikut operacional në planifikimin strategjik.

OBJEKTIVAT AFATMESEM

MASAT

2.11. SIGURIA KIBERNETIKE

<p>a) Forcimi i qëndrueshmërisë kibernetike të sistemit bankar shqiptar</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Përmirësimi dhe modernizimi i kuadrit rregullativ për mbikëqyrjen e rrezikut kibernetik dhe përshtatja e tij me legjislacionin evropian. – Adoptimi i standardeve ndërkombëtare për vlerësimin e mjaftueshmërisë së kontrolleve të perimetrit të sigurisë ndaj sulmeve kibernetike dhe vijueshmërisë së veprimtarisë së subjekteve të licencuara. – Adoptimi i standardeve ndërkombëtare (ISO 27002: 2022) për vlerësimin e përgatitjes së bankave në kuadër të mbrojtjes nga sulmet kibernetike dhe vijueshmërisë së veprimtarisë së subjekteve të licencuara. – Rritja e bashkëpunimit me bankat ndaj sulmeve kibernetike dhe kontributi aktiv në industrinë bankare për shkëmbimin e informacionit dhe bashkërendimin e reagimit, në kohë reale, ndaj çdo incidenti.
<p>b) Forcimi i qëndrueshmërisë kibernetike të infrastrukturës së Bankës së Shqipërisë</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Adoptimi i legjislacionit evropian për integrimin dhe administrimin në kuadër të trajtimit të rrezikut kibernetik në të gjitha proceset e Bankës së Shqipërisë. – Rritja e qëndrueshmërisë së sistemeve të pagesave e të shlyerjes me rëndësi sistemike dhe sistemeve të tjera të brendshme. – Modernizimi i linjave mbrojtëse me qëllim rritjen e efektivitetit të zbulimit dhe reagimit ndaj sulmeve kibernetike. – Forcimi i kapaciteteve teknike dhe njerëzore në kuadër të sigurisë kibernetike, për t'i shërbyer një veprimtarie inovative dhe të sigurt. – Përmirësimi i planeve të vijimësisë dhe reagimit ndaj rreziqeve kibernetike, mbështetur në standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira për mbrojtjen kibernetike.

OBJEKTIVAT AFATMESËM	MASAT
c) Bashkëpunimi/ndërveprimi me institucione kombëtare e ndërkombëtare	<ul style="list-style-type: none"> – Forcimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimi i informacionit me institucionet përgjegjëse për sigurinë kibernetike në vend dhe me sistemin bankar. – Rritja e bashkëpunimit me partnerë kyç ndërkombëtarë për forcimin e kapaciteteve në kuadër të administrimit të rreziqeve kibernetike.
d) Rritja e ndërgjegjësimit	<ul style="list-style-type: none"> – Rritja e besimit të publikut në përdorimin e sigurt të mjeteve digjitale në veprimtaritë financiare, përmes integritimit të sigurisë kibernetike në edukimin financiar. – Rritja e ndërgjegjësimit të punonjësve për rolin e tyre në garantimin e sigurisë së sistemeve të informacionit të Bankës së Shqipërisë.